



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo/ RepublicOfKosovo



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas
AgencijazaBesplatnuPravnuPomoć
AgencyforFree Legal Aid

KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

ANJF-2013/4

RREGULLORE **PËR ANGAZHIMINE AVOKATËVE**

Rr."ZenelSalihu" nr. 30 – Ul. "ZenelSalihu" br. 30 – St. "ZenelSalihu" no. 30
Tel. +381 (0) 38 200 18 936 – ueb www.knj-rks.org

Në përputhje me dispozitat e nenit 29 paragrafi 4 dhe 6, të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas , Këshilli për Ndihmën Juridike Falas, në takimin e mbajtur më 01.03.2013,

Nxjerr:

RREGULLORE PËR ANGAZHIMIN AVOKATËVE

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton procedurën e angazhimit dhe të kompensimit të avokatëve të angazhuar nga zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në pajtim me Ligjin Nr.04/L-017, për Ndihmë Juridike Falas.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë avokatët e licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës me rastin e angazhimit të tyre nga ANJF-ja.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 ANJF- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.
 - 1.2 **Avokat**- Anëtar i Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës.
 - 1.3 **Lista e avokatëve për ANJF**– nënkupton listën e avokatëve të përgatitur nga Oda e Avokatëve të Republikës së Kosovës për ANJF.
 - 1.4 **Angazhim nga ANJF** – Dhënia e autorizimit nga ANJF-ja për avokatin e caktuar për përfaqësim dhe për ndërmarrjen e veprimeve për palën përfituese të ndihmës juridike falas.
 - 1.5 **Rimbursimi i mjeteve** – Shpenzimet e shkaktuara me zhvillimin e procedurës gjyqësore, kërkohen të kompensohen nga pala e kundërt në llogari të ANJF-së.

Neni 4

Përpilimi i parashtresave

Për përpilimin e parashtresave me të cilat inicohet zhvillimi i cilësdo procedurë para gjykatës apo organit tjetër, avokatit i takon kompensimi sipas vlerës së caktuar në tarifën e ANJF-së, të aprovuar nga Këshilli për Ndihmë Juridike Falas.

Neni 5

Përfaqësimi në seanca

Për përfaqësim në seanca në lëmin civile, administrative penale dhe kundërvajtëse, avokatika të drejtë në kompensim, për angazhimin e tij për lëndën konkrete, sipas tarifës, në mënyrë të përcaktuar si në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Mjetet juridike

1. Për përpilimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga avokati për palën përfituese të ndihmës juridike, avokati ka të drejtë në kompensim sipas shumës së përcaktuar me tarifë të ANJF-së, në këto procedura:
 - 1.1 Në procedurën civile
 - 1.2 Në procedurën administrative
 - 1.3 Në procedurën penale
 - 1.4 Në procedurënkundërvajtëse

Neni 7

Pagesa

- 7.1. Pagesa nga ana e ANJF-së për avokatët e angazhuar për palët përfituese të ndihmës juridike falas bëhet përmes sistemit Free Balance në llogarinë e tij bankare.
- 7.2. Për procedimin e një lënde të avokatit për pagesë duhet të prezantohen në ANJF këto dokumente,
 1. autorizimin dhe kontratën nga ANJF,
 2. veprimin e ndërmarrë nga avokati,
 3. tabelën për veprimet të ndërmarra,
 4. faturën origjinale,
 5. certifikatën e biznesit
 6. numrin fiskal
 7. kartelën e bankës
 8. Letërnjoftimin.

7.3.Maksimumi i pagesës për një lëndë është i përcaktuar në tarifë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Më: 12.03. 2013Kryesues i Këshillit

Alban Sutaj
